

Qasja me dëshmitë e protagonistëve të fillimeve demokratike si burim etik për historinë, rasti i Viktor Martinit.

Dr. Leka Ndoja

Letërsia e burgut, letërsia Underground, letërsia e nëndheshme, letërsia e sirtareve, letërsia e dënuar. Këto janë disa emërtime që ka marrë letërsia e memories dhe e salvimit gjatë komunizmit në Shqipëri.

Dikush si Visar Zhiti ka shkuar përtej emërtesës duke e ngarkuar me sarkazëm kategorinë e kësaj letërsie duke e pagëzuar si "burgologji".

Kësisoj, këto emëttesa të rryeshme kanë kategorizuar një pjesë të letërsisë që gjalloi për 30 vitet e para të postkomunizmit në sistemin letrar shqiptar.

Gjithë kjo masë letrare krijoi një sistem të panjohur më parë, por që popullarizimin më të madh e kishte marrë me përhapjen në sistem të gjinisë sarkastike (atë të barcaletave politike) si metodë që destruktonte narrativën propagandistike dhe ideologjinë komuniste.

Rasti i Viktor Martinit, në funksionin e narratorit si protagonist i ngjarjeve, i pranëvitet prozës memuaristike dhe analizës së ngjarjeve parë në perspektivë duke ndërthurur rrëfimin në vetë të parë, me pësimet subjektive por edhe të figurave ma të nalta të disidencës së Europës lindore si At Pjetër Meshkalla duke rindërtuar gjyqin publik të kryer ndaj tij nga Sigurimi i Shtetit në Sallën e Institutit Pedagogjik të Shkodrës.

Në kujtimet e Viktor Martinit bëhet pjesë një Galeri e figurave të epërme intelektuale të Shkodrës duke sjellë detaje dhe fakte të panjohura në ngjarjet politike në të cilat u përfshinë.

Autenticiteti i memorieve të Viktor Martinit, nis në mënyrë koncentrike duke u nisur nga familja e tij e njohur si vlerë primordiale dhe unifikuese dhe duke e vendosur në raport me shoqërinë e kohës e cila përshkruhet në kontekstin e ngjarjeve, duke i përmendur dobësitë karakteriale por duke i përshkruar në dritën e faljes e të mëshirës kristiane, si një ve[ori përtej dëshmimeve okulare.

Pjesë e rrefimeve të Martinit janë paradokset e kohës, intrigat e hetuesve dhe instrumenteve të tyre duke dhënë një panoramë të besueshme për qëndresën e viktimave të komunizmit por edhe dobësitë e tyre.

Për sa i përket, këtij aspekti të analizës së veprimtarisë të protagonistëve të protestave dhe fillimeve demokratike në Shkodër dhe në Shqipëri, autori analizon faktorët që sollën ndryshimet demokratike: dhe përpjekjet e Dom Simon Jubanit,

Pjetër Arbnorit, Ali Spahisë për të krijuar një forcë opozitare. Si dhe përfshirja e tyre si vlerë morale në Partinë Demokratike, duke dëshmuar vështirësitë e krijimit të një force etike antikomuniste, kjo shpjegohet nga autori jo për paaftësinë e tyre, por për gjendjen reale të shoqërisë e cila ishte larg njohjes së vlerave që sollën të burgosurit politikë, të cilëve iu mohua hapësira publike e shprehjes por edhe u etiketuan si ekstremistë derisa u mënjanuan nga drejtimi i partive politike pr edhe u shtynë të emigronin sikundër rasti i familjes së Viktorit.

Kujtimet e Viktorit për periudhën postkomuniste dhe atë të emigracionit politik shpesh përcillen si analiza ku përpos kritikës ndaj protagonistëve politikë përcillen konceptet universale të sendërtuara nga At Meshkalla si model trashëndental dhe etik për rindërtimin e shoqërisë.

Narrativa e Viktor Martinit në disa vepra do të vlejë si burim etik për receptimin e historisë në shmang të hemiplegrisë së kujtesës.